



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 481/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Prizren, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 13:15, në ditën e zgjedhjeve kemi vërejtur se para dy qendrave të votimeve në Prizren, në shkollën Fillore “Lek Dukagjini”, 2007A, si dhe në shkollën fillore “Luciano Matrioni”, 2008A, qëndrontë vazhdimisht një grup njerëzish të kordinuar nga kandidati për asamble komunale dhe anëtari i kryesisë së PDK-së Alush Shala të cilit duke ofruar dhe ndihmuar bënë një presion ndaj votuesve. Sipas parashtruesit të ankesës janë bërë shkelje të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme përkatësisht nga neni 34 si dhe neni 34.2.LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografit si dëshmi nga vendi i ngjarjes, me ç’rast pasi kemi siguruar dëshmitë kemi përgaditur ankesën pranë PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së parshihet se “Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t’i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të LDK ndaj subjektit politik PDK-së. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të

pabazuara, pasiqë nga dëshmitë e ofruara nuk janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 481/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (orë)orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.